



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-123

Prishtinë, më 5 shtator 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 5 SHTATOR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Rasim Demiri, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq, Myfera Shinik dhe Goran Marinkoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga: OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 29 korrik 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 29 korrik 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 29 korrik 2013.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 12 shtator 2013, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012,*
5. *Shqyrtimi i raportit vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2012,*
6. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2012,*
7. *Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri për mbikëqyrjen e buxhetit të institucioneve të sigurisë në Republikën e Kosovës,*
8. *Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara,*
9. *Shqyrtimi i raportit të Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së,*
10. *Formimi i Komisionit ad hoc për shqyrtimin e aplikacioneve lidhur me përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së,*
11. *Zgjedhja e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur për Media.*

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave:

1. Propozimi për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Për propozimin e lartshënuar diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, Xhavit Haliti dhe Glauk Konjufca, nënkryetarë të Kuvendit; Ardian Gjini, kryetar i GP të AAK-së dhe Sasha Milosavljeviq, kryetar i GP të SLS-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga grupet parlamentare që të diskutojnë me deputetët nënshkrues lidhur me propozimin e deputetit Amir Ahmeti për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht ndryshimin e nenit 8 të Kushtetutës.

2. Procedimi i aplikacioneve për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së

Kryesia, pikën e lartshënuar e radhiti në rend të ditës për mbledhjen plenare të radhës, si dhe nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga grupet parlamentare që deri në seancën e radhës, më 12 shtator 2013, t'i propozojnë deputetët për anëtarë për formimin e Komisionit ad hoc për shqyrtimin e aplikacioneve për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.
2. Përbërja e komisionit duhet të jetë: GP i PDK-së, 2 anëtarë; GP i LDK-së, 2 anëtarë; GP VV, 1 anëtar; GP i AAK-së, 1 anëtar; GP i KKR-së, 1 anëtar; GP SLS/GP ZB-së, 1 anëtar dhe GP 6+, 1 anëtar.

3. Procedimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me raportin e Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së

Kryesia, raportin e lartshënuar e radhiti në rend të ditës për mbledhjen plenare të radhës.

4. Informata për gjendjen në Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi.

Kryesia, pasi u njoftua me gjendjen në Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kuvendi, para se të marrë vendim për Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi duhet të presë deri në përfundimin e procedurës gjyqësore të lëndës lidhur me këtë çështje.

5. Shqyrtimi i propozim-Rregullores për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Sekretari i Kuvendit, në lidhje me propozim-Rregulloren për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës theksoi se e njëjta rregullore është miratuar nga Kryesia në vitin 2010, ndërsa me mbështetje të ekspertëve të projektit të binjakëzimit, në vitin 2012 është hartuar Rregullorja për rregullat statusore në Administratën e Kuvendit, mirëpo në ndërkohë ka dalë edhe një këshillë dhe një sugjerim, të cilin e kemi propozuar si shtim i nenit 27 në Rregulloren aktuale, ku është lënë mundësia që për rrethana të veçanta të tregut të punës dhe sfondit të kualifikimeve profesionale të përcaktuara, kur përvoja e punës nga përshkrimi aktual i vendit të punës nuk përmbushet nga kandidati eventual, i paraqitur konform kriterëve të Rregullores, sekretari mund të bëjë shmangie, duke u bazuar në raportin e panelit intervistues, të drejtorit të Zyrës së Personelit dhe drejtorit të Drejtorisë të Përgjithshme të Administratës. Pra, sekretari mund të marrë vendim ta pranojë kandidatin edhe në rast të ekzistimit të ndonjë shmangieje nga kriteret e parapara me Rregulloren për punësim në Administratën e Kuvendit, gjithmonë në bazë të arsytimit të qëndrueshëm.

Për propozim-Rregulloren e lartshënuar diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, nënkryetarë të Kuvendit, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozim-Rregulloren e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që në bashkëpunim me ekspertët e Projektit të Binjakëzimit ta hartojnë dhe procedojnë Projektligjin për Kuvendin e Republikës së Kosovës brenda vitit 2013.

6. Propozimi për shpalljen e tenderit për blerjen e veturave zyrtare të Kuvendit

Për propozimin e lartshënuar diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti dhe Xhavit Haliti, nënkryetarë të Kuvendit, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Administrata e Kuvendit që në bazë të dispozitave të Ligjit për prokurimin publik të bëjë shpalljen e tenderit për blerjen e 5 (pesë) veturave zyrtare, në kapacitet 1,9 cm3, për nevojat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale